



Parlamenti miratoi Projektligjin “ Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”

Parlamenti i Shqipërisë miratoi uljen me 5 vjet të moshës së daljes në pension për të gjithë minatorët, nga 60 vjeç në 55 vjeç. Projektligji, u miratua me 78 vota pro dhe asnjë kundër, Do të përfitojnë gjithsej 3840 minatorë. Realizohet kështu kërkesa shumëvjeçare e Sindikatës së Pavarur të Minatorëve të Shqipërisë dhe BSPSH-së. Sipas këtij ligji kanë të drejtë të kërkojnë pension pleqërie si punonjës të minierave, në nëntokë, punonjësit, të cilët: a) arrijnë moshën 55 vjeç; b) kanë një periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë, nga të cilat jo më pak se 12 vjet e 6 muaj të jenë në procese pune në miniera, në nëntokë. Përfshihen nga kushtet e vendosura në shkronjën “ b” të këtij neni, ish punonjësit e nëntokës që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr 8685, Dt 09.11.2000, “për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, të cilët do të përfitojnë pension sipas këtij ligji kur të arrijnë moshën 55 vjeç dhe të kenë një periudhë të përgjithshme sigurimi 30 vjet e më shumë (përfshirë këtu edhe periudhën e trajtimit të veçantë financiar), nga të cilat, jo më pak se 11 vjet e 6 muaj të jenë në procese pune në miniera, në nëntokë.



